

## **Raport për vlerësimin në kuadër të procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve (Follow-Up) për programin**

### **Msc në "Menaxhim në Inxhinieri", Shkolla Private e Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana"**

Programi Master i Shkencave në "Menaxhim në Inxhinieri" është akreditur me kusht me Urdhërin e MAS Nr. 9, datë 07.01.2016, "Për Akreditimin me Kusht të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në "Menaxhim në Inxhinieri", mbështetur në VKA Nr. 109, datë 03.11.2015.

Në pikën 3 të UMAS Nr. 9, datë 07.01.2016 theksohet shprehimisht: "Shkolla Private e Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana" duhet të marrë masa të menjëherëshme për plotësimin e kushteve konform vendimeve përkatëse të këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe plotësimin e rekomandimeve".

Më datë 25.10.2016 SHPAL "Universiteti Metropolitan Tirana" paraqet pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, shkresën me Nr.520/1 prot, datë 30.09.2016 "Për plotësimin e kushteve të lëna në Vendimet Nr. 109/1 datë 18.12.2015 dhe Nr. 110/1, datë 18.12.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë". Në këtë shkresë Institucioni deklaron se ka plotësuar kushtin dhe rekomandimet e lënë në VKA.

Më mëposhtë paraqitet raporti i vlerësimit teknik dhe në përbajtje në lidhje me shkallën e përbushjes së kushteve të vendosura në VKA Nr. 109, datë 03.11.2015, dokumentacioni që paraqet nga Institucioni dhe masat që janë marrë për plotësimin e kushteve. Vlerësimi i ekspertit të jashtëm bazohet në këtë dokumentacion dhe vizitën në institucion.

Kushtet e vendosura në VKA Nr. 109, datë 03.11.2015	Vlerësimi teknik	Vlerësimi i Ekspertit
a. Të shtojë dhe të angazhojë personel akademik efektiv për të arritur plotësisht standartin e mbulimit deri në 70% të ngarkesës mësimor me staf akademik efektiv.	Në lidhje me plotësimin e këtij kushti Institucioni ka paraqitur planin mësimor për vitin akademik 2015-2016 dhe 2016 -2017. Në planin mësimor jepen emrat e pedagogeve, lënda që ata mbulojnë si edhe ngarkesa mësimore.  <i>Shënim:</i> Në planin mësimor të paraqitur nga institucioni vërehet rritja e numrit të stafit akademik efektiv. Krahasuar me stafin efektiv të paraqitur ne RVB numri i pedagogëve efektiv është rritur nga 6 në 9, pra stafi efektiv në fillim mbulonte 56% të ngarkesës mësimore kurse ai aktual bazuar në dokumentacion e	Bazuar në vlerësimin teknik si edhe në dokumentacionin që institucioni ka paraqitur por edhe nga vizita në institucion dhe takimi me rektorin, përgjegjësin e departamentit që mbulon këtë program studimi si edhe nga verifikimi i dosjeve personale të personelit akademik pranë zyrës së burimeve njerëzore, rezulton se institucioni ka marrë masat për të plotësuar kushtin e vendosur nga VKA Nr.109 datë 03.11.2015. Kështu, për programin e studimit Master i

	<p>paraqitur mbulon 71.9 % të ngarkesës mësimore dhe stafi me kontratë 28.1% të ngarkesës.</p> <p><i>Dokumentacioni i paraqitur nga IAL është i plotë.</i></p>	<p>Shkencave në Menaxhin në Inxhinieri, aktualisht, janë të angazhuar më shumë se 70% staf akademik efektiv.</p> <p><i>Kushti është plotësuar</i></p>
--	--	---

#### Rekomandimet e lëna në VKA Nr. 109, datë 03.11.2015

Rekomandimet e lënë në VKA Nr. 109, datë 03.11.2015	Vlerësimi teknik	Vlerësimi i Ekspertit
b. Përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze tek studentët përtu mundësuar këtyre të fundit, përdorimin e literaturës në gjuhën angleze	<p>Në kuadër të përbushjes së këtij rekomandimi institucioni deklaron se ka punësuar profesorë të huaj.</p> <p>Në mbështetje të këtij rekomandi Institucioni ka paraqitur kontratat e punës të nënshkruara nga pedagogëvet e huaj të punësuar pranë institucionit si edhe sylabuset në gjuhën angleze.</p> <p><i>Dokumentacioni i paraqitur nga IAL në përbushje të këtij rekomandimi është i plotë.</i></p>	<p>Bazuar në vlerësimin teknik por edhe në takimin me përgjegjësin e departamentit si edhe në verifikimin e dosjeve personale të personelit akademik, rezulton se institucioni ka punësuar pedagogë të huaj të cilët janin mësim në gjuhën angleze duke mundësuar kështu përmirësimin e nivelit të anglishtes tek studentët si edhe mundësinë përtë përdorur literaturë në gjuhë angleze.</p> <p><i>Rekomandi është plotësuar</i></p>
c. Të përfshihen detyrat e kursit në lëndët ku mungojnë.	<p>Në mbështetje të këtij rekomandimi institucioni ka paraqitur Vendimin e Senatit Akademik me Nr. 705/1 prot, datë 01.10.2016 si edhe programin e lëndëve "Programin dhe menaxhim kantieresh" dhe "Tregu dhe instrumentat financiare". Në vendimin e senatit është paraqitur shpërndadja e krediteve (ECTS) përtë dyja lëndët. Vihet re se për secilën nga lëndët institucioni ka zvogëluar orët e leksioneve nga 70 orë në 50 orë, ka shtuar orët e seminareve nga 20 orë në 35 orë dhe të detyrave të kursit me 5 orë. Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në përbushje të këtij rekomandimi rezulton se detyrat e kursit kanë nga 0.5 kredite ECTS.</p> <p>Planet e të dyja lëndëve janë të plota dhe në to janë paraqitur mënyra e vlerësimit, objektivat e lëndës, format e mësimdhënies</p>	<p>Bazuar në vlerësimin teknik, dokumentacionin e paraqitur nga institucioni si edhe nga takimi me përgjegjësin e departamentit, rezulton se ka një rishpërndarje të krediteve të disa lëndëve, duke shtuar detyrën e kursit si një detyrim të lëndëve përkatëse me përkatësisht 0.5 ose 1 ECTS. Në planin mësimor si edhe programet përkatëse të lëndëve rezultojnë ndryshimet e bëra në shpërndarjen e krediteve dhe vendosjen e detyrave të kursit në lëndët si : "Programim dhe menaxhim i kantiereve" Leksion 6ECTS/Seminar 2 ECTS/Detyrë kursi 1 ECTS.;</p>

	<p>literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p> <p><i>Dokumentacioni i paraqitur nga IAL në përmbushje të këtij rekomandimi është i plotë.</i></p>	<p>si edhe për lëndën: "Tregu dhe instrumentat financiare" Leksion 5 ETCS/Seminar 3.5 ETCS/Detyrë kursi 0.5 ECTS.</p> <p><i>Rekomandimi është plotësuar</i></p>
d. Të parashikohet në planin mësimor lënda e menaxhimit të burimeve njerëzore.	<p>Në mbështetje të këtij rekomandimi institucioni ka paraqitur Vendimin e Senatit Akademik me Nr. 705/1 prot, datë 01.10.2016 si edhe programin e lëndës "Menaxhim i Burimeve Njerëzore". Në vendimin e senatit përcaktohet se kjo lëndë do të futet në grupin e lëndëve me zgjedhje dhe do të këtë 6 ECTS. Në programin e lëndës janë përcaktuar mënyrat e mësimdhënies që do të jenë: leksione dhe seminare, (nuk do të këtë detyra kursi), janë përcaktuar mënyra e vlerësimit, objektivat e lëndës, literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p> <p><i>Dokumentacioni i paraqitur nga IAL në përmbushje të këtij rekomandimi është i plotë.</i></p>	<p>Bazuar në vlerësimin teknik, në planin mësimor për vitin akademik 2016-2017 si edhe në vizitën në institucion duke parë edhe regjistrin e vtit të parë të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim në Inxhinieri, vihet re se lënda "Menaxhim i burimeve njerëzore", që është rekomanduar si lëndë për tu zhvilluar po zhvillohet si lëndë me zgjedhje në semestrin e dytë.</p> <p><i>Rekomandimi është plotësuar</i></p>

#### Dokumentacioni i paraqitur pranë APAAL:

1. Vendimi i Senatit Nr.705/1 prot, datë 01.10.2016
2. Syllabusi i lëndës Tregu dhe instrumentat Financiare
3. Syllabus i lëndës Programim dhe Menaxhim I Kanatiereve
4. Syllabus il lëndës Menaxhim I burimeve njerëzore
5. Plani mësimor 2015 – 2016; 2016 – 2017
6. Kontrata pune për Msc. Menaxhim në Inxhinieri

## **7. Syllabus në gjuhën angleze.**

### **Dokumentacioni i marrë në institucion:**

#### **1. Kopje të regjistrat të studentëve për lëndën Menaxhim i Burimeve Njerëzore.**

### **Konkuzion përfundimtar:**

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni në përmbushje të kushtit dhe rekomandimeve të lënë në VKA si edhe nga vizita e realizuar në institucionit, vihet re:

- Plotësimi i kushtit të vendosur për të mbuluar procesin e mësimdhënies me 70% staf akademik efektiv.
- Marrjen parasysh të rekomandimeve të dhëna për të përfshirë më tepër literaturë në gjuhë angleze, për të përfshirë në numrin total të krediteve në disa lëndë edhe detyra kursi si edhe për të përfshirë në grupin e lëndëve edhe lëndën e "Menaxhimit të burimeve njerëzore".

### **Eksperti i vlerësimit**

**Dr. Irma Shyle**

